



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 19/11

Prishtinë, më 13.07.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Naser Osmani, Hykmete Bajrami dhe Jelena Bontić.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Aleksander Beetz, Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 06.07.2011;**
- 3. Shqyrtimi i shkresës mbi pengesat në përmbushjen e Misionit Kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit;**
- 4. Miratimi i amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit;**
- 5. Miratimi i amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr.04/L-024 për Ndihmën Shtetërore;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-28 për Dizajnin Industrial me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-26 për Markat Tregtare me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-29 për Patenta me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-22 për përdorimin civil të Eksplozive me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme;**
- 10. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.
Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 06.07.2011

Procesverbali miratohet pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i shkresës mbi pengesat në përmbushjen e Misionit Kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit

Kryetarja, theksoi që Institucioni i Avokatit të Popullit ka sjellur një shkresë në Kuvend lidhur me pengesat që i ka ky institucion në përmbushjen e Misionit Kushtetues dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për rrjedhën e buxhetit të këtij institucioni. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 nuk është proceduar brenda afateve kohore në Kuvend për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe është kërkuar që të gjitha agjencionet e pavarura t'i riprocedojnë kërkesat e tyre në Komision për Buxhet dhe Financa. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka sjellur një kërkesë të riplotësuar dukë përfshirë edhe kërkesën për pagat e Avokatit të Popullit dhe Zëvendësve të tij. Në total, kërkesa e këtij institucioni ishte më e lartë se sa buxheti i aprovuar nga Qeveria, si dhe 18 punëtorë më tepër të planifikuar. Në arsyetimin e kërkesës për ricaktimin e avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij, me miratimin e Ligjit nr.03/1-195 për Avokatin e Popullit, është rregulluar që paga e Avokatit të Popullit dhe Zëvendësve të tij do të caktohen në bazë të Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik, i cili ligj nuk ekziston. Duke vlerësuar rëndësinë e veçantë që ka ky institucion kushtetues dhe punën e Avokatit të Popullit, në mungesë të bazës ligjore dhe duke i pasur parasysh kufizimet buxhetore, komisioni kishte rekomanduar që paga e avokatit të popullit dhe pesë zëvendësve të tij të rritej për 30%, rekomandim ky i cili ishte aprovuar në formë të amendamentit së bashku me raportin me amendamente për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. Komisioni kishte rekomanduar edhe shtimin e një punëtori dhe ndarjen e mjeteve shtesë për mallra dhe shërbime në emër të pagesës së qirasë. Komisioni vlerëson të pamatura deklaratat e IAP-së, ku thuhet se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vepruar në mënyrë antiligjore dhe diskriminuese me rekomandimin për rritjen e pagës për 30%. Është në kuadër të fushëveprimtarisë së komisionit të caktuar me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës të shqyrtojë Projektligjin për Buxhetin dhe t'i rekomandojë Kuvendit për ndryshimin dhe plotësimin e tij që do të thotë se komisioni ka vepruar në mënyrë ligjore. Megjithatë duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit kushtetues të këtij institucioni dhe me qëllim që buxheti të mos jetë pengesë në kryerjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore që ka Institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioni për Buxhet dhe Financa, është i gatshëm të trajtojë çfarëdo kërkesë të këtij institucioni që parashtrohet para komisionit për shqyrtim, brenda kornizës ligjore dhe mundësive buxhetore. Institucioni i Avokatit të Popullit, ka dërguar kërkesën buxhetore për vitin 2012 në Kuvend, Komisioni sipas procedurës së rregullt, me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe kërkesave buxhetore, do të organizojë dëgjim buxhetor me këtë institucion, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kërkesave të parashtruara dhe brenda bazës ligjore dhe mundësive buxhetore, do të nxjerr rekomandimet për miratim në seancën plenare të Kuvendit.

Sali Asllanaj, theksoi që në bazë të kronologjisë së ngjarjeve shihet se nuk ka pasur shkelje ligjore, mirëpo ka pasur defekte në procedurat që kanë rrjedhur në IAP duke mos marrë pjesë në dëgjimet buxhetore. Propozoi që të ftohet Avokati i Popullit dhe të diskutohet për të gjetur një zgjedhje të përbashkët.

Xhevdet Neziraj, theksoi që në kërkesat e paraqitura nga IAP, janë disa kërkesa të cilat nuk mund t'ua sigurojë Komisioni për Buxhet dhe Financa, siç është kërkesa për gjetjen e hapësirës pasi që ajo duhet të rregullohet me Ministrinë e Administratës Publike. Kërkesa për paga mund të shqyrtohet vetëm nëse bëhet rishikimi i buxhetit ose të mbetet për vitin tjetër. Gjithashtu agjencionet e pavarura duhet të jenë më të përgatitura dhe të bashkëpunojnë më tepër me Ministrinë e Financave.

Kryetarja, propozoi që Kryesisë së Kuvendit t'i dërgohet një informatë duke paraqitur kronologjinë e ngjarjeve si kanë shkuar në lidhje me këtë institucion dhe të mbahet një takim me IAP-në për të parë se cilat janë kërkesat e domosdoshme që duhet të aprovohen për këtë periudhë.

4. Miratimi i amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit

Kryetarja, njoftoi që grupi punues ka punuar në amendamentet e PL për Akcizën në Produktet e Duhanit, mirëpo pasi që z.Naser Osmani i cili ka qenë kryesues i këtij grupi punues nuk është prezent, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër të radhës.

Pas propozimit, Komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

Shtyhen raporti i grupit punues për Projektligjin nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, për mbledhjen e radhës së Komisionit

5. Miratimi i amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore

Albana Fetoshi, kërkoi që amendamentet t'u dërgohen më herët në mënyrë që të ketë më shumë kohë për t'u shqyrtuar.

Kryetarja, njoftoi që grupi punues i ka përfunduar amendamentet të enjten, mirëpo po ka vonesa në përkthimin e tyre dhe është nxituar të vendosen në këtë mbledhje edhe pse janë sjellur me vonesë.

Albana Fetoshi, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Duda Balje, propozoi që kjo pikë nuk duhet të shtyhet për mbledhjen tjetër, sepse ai i cili nuk i kupton amendamentet mund të kërkojë sqarime.

Pas propozimit, Komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

Shtyhen raporti i grupit punues për Projektligjin 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore, për mbledhjen e radhës së Komisionit

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-28 për Dizajnin Industrial me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-26 për Markat Tregtare me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-29 për Patenta me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-22 për përdorimin civil të Eksplozive me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

10. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për t'u diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj